



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.SHk.Dytë.nr.696/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË- Dhoma e Shkallës së Dytë, nga gjyqtari individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditoritme seli në Prishtinë kundër debitorëve: shpk me seli në fshatin Komuna e Gjakovës të cilën e përfaqëson Gj.B.dhe D.B.nga fshati Komuna e Gjakovës të cilin me autorizim e përfaqëson Yll Xhiha nga Gjakova, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit D.B. nga fshati Komuna e Gjakovës, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, PPP.153/2021, i datës 12.08.2021, jashtë seancës me datë 23.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit D.B.nga fshati Komuna e Gjakovës, Gjakovës, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, PPP.153/2021, i datës 12.08.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë me Aktvendimin e ankimuar PPP.153/2021, i datës 12.08.2021, e ka refuzuar ankesën e debitorit D.B. nga fshati Komuna e Gjakovës, me të cilën debitori ka kërkuar që të eliminohen parregullsitë e përmbartuesit privat Gjakë Radi nga Gjakova në lëndën P,nr.92/21 në çështjen e përmbartimit.

Kundër këtij aktvendimi debitori D.B. nga fshati Komuna e Gjakovës përmes të autorizuarit Yll Xhiha avokat nga Gjakova, ka parashtruar ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, detyrimore, përmbartimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovoj ankesën e debitorit si të bazuar ndërsa aktvendimin e atakuar ta anuloj.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur kreditori me propozim që të refuzohet ankesa e debitorit si e pa bazuar, të vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë PPP.153/21, i datës 12.08.2021, dhe në përputhje me Urdhërin për Përmbarrim P.nr.05/17 të vazhdohet me procedurën e përmbarrimit.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditorime seli në Prishtinë (ish sh.a me seli në Prishtinë), me datë 04.03.2021, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorëve shpk me seli në fshatin Komuna e Gjakovës dhe D.B. nga fshati Komuna e Gjakovës, në bazë të kontratës për mbitërheqjen nr.01/04 e datës 28.06.2004 dhe kartela e llogarisë e datës 06.10.2005.

Debitori D.B.nga fshati Komuna e Gjakovës, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, ka parashtruar në Gjykatën Themelore në Gjakovë, ankesë me arsyetimin se ka mungesë të kontratës së firmosur nga ana e debitorve dhe e kundërshtojnë të kenë marrë kredi apo shumë të caktuar të mjeteve financiare, që vërtetohet nga eksperti i ekonomisë A.Sh..

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur lidhur me kërkesën e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.153/21 i datës 12.08.2021, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e debitorit, duke vendosur si në dispozitiv të të njëjtit. Në arsyetimin të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se është i pabazuar pretendimi i debitorit pasi që në shkresat e lëndës nuk është vërejt se ka parregullsi në veprimet e e përmbarruesit privat. Propozimi për përmbarrim është lejuar në bazë të dokumentit përmbarrimor kontratës për hipotekën e lidhur mes kreditorit dhe debitorit të parë. Kontrata për hipotekën e datës 25.06.2004 është lejuar vendosja e hipotekës me aktvendimin e saj IN.nr,233/2004 dt.28.06.2004. Gjykata e shkallës së parë nuk ka vërejtur asnjë parregullsi në punë e përmbarruesit privat.

Gjykata Komerciale- Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marrë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë gjendjen faktike të dokumentacioneve në procedurën përbarimore. Kjo gjykatë nuk ka gjetur asnjë provë materiale nga të cilat mund të vërtetohen pretendimet ankimore të debitorit se ekzistojnë parregullsi në veprimet e përbaruesit privat Gjakë Radi nga Gjakova.

Kontrata për hipotekën e datës 25.06.2004 dhe aktvendimi i ish Gjykatës Komunale në Gjakovë me aktvendimin INr.232/2004 me të cilin është lejuar vendosja e hipotekës, në rastin konkret është dokument përbarues, dhe kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së e cila dispozitë përcakton se: "Dokument përbarues është edhe vendimi përbarues i dhënë në procedurë administrative" dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përbarimit sipas nenit 21 duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragrafi 3 dhe 27 paragrafi 1 të po këtij ligji ku përcaktohet se: "Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit".

Në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatojë përbarimin.

Dhoma e Shkallës së Dytë i ka vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore por të njëjta kanë rezultuar si të pathemelta pasi që në këtë çështje juridike përbarimore përbarimi është lejuar në bazë të aktit administrativ i cili i plotëson kushtet për përbarim dhe është i përshtatshëm për përbarim.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II nr.696/2022, me datë 23.08.2022

Gjyqtari
Krenar Berisha